



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0300

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori kryetare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Olti Trasing SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Inventarizimi me numër të prokurimit 616-25-6903-1-1-1, me 16/06/2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE Olti Trasing SH.P.K. me nr. 2026/0300 , e datës 08/05/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Inventarizimi me numër të prokurimit 616-25-6903-1-1-1.

2. Mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Inventarizimi me numër të prokurimit 616-25-6903-1-1-1

3. Lejohetkthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtoj kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 30.07.2025. KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i shkollës 7 shtatori - Inventarizimi" me nr. të prokurimit: "616-25-6903-1-

1-1"

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: pune, vlera e parashikuar e kontrates: 200,000 €.

Me23.04.20206. KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Wood Corporacion LLC”,

Me 28.04.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 28.04.2026. AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 08.05.2026, OE “Olti Trasing SH.P.K. ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokoll 2026/0306, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kunder dhenies së kontrates.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Olti Trasing SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, pas vendimit të datës 05.03.2026 për kthimin e lëndës në rivlerësim, më datë 23.04.2026 në platformën e E-Prokurimit ka publikuar Formularin B58 – Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për shpërblimin me kontratë të OE WOOD CORPORATION L.L.C., në vlerë totale prej 199,185.00 €.

Më datë 23.04.2026, përmes platformës së E-Prokurimit, kemi paraqitur kërkesë për qasje në dokumentet e tenderit, ndërsa Autoriteti Kontraktues më datë 24.04.2026 na ka lejuar vetëm qasje të pjesshme, pasi nuk na ka mundësuar qasje në raportin e vlerësimit të ofertave, ashtu siç kemi kërkuar, por vetëm na ka dorëzuar në USB dokumentet e ofertës së OE-së së shpërblyer me kontratë, WOOD CORPORATION L.L.C.

Kompania jonë nuk është pajtuar me vendimin e Autoritetit Kontraktues për eliminimin nga aktiviteti i prokurimit dhe me vendimin për shpërblimin me kontratë të OE WOOD CORPORATION L.L.C.. Bazuar në faktet dhe argumentet që posedojmë, më datë 28.04.2026, përmes platformës së E-Prokurimit, kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës. Më datë 05.05.2026, përmes platformës së E-Prokurimit, kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim si të pabazuar.

Pretendimet ankimore lidhur me ofertën e Grupit të OE-ve: Olti Trasing SH.P.K. & Fatini SH.P.K.

Shkelje e nenit 59 dhe nenit 7 të LPP-së, si dhe e nenit 40 të Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik

Autoriteti Kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës e ka bërë eliminimin e kompanisë sonë dhe rekomandimin për shpërblim me kontratë të OE WOOD CORPORATION L.L.C. në kundërshtim të plotë me nenin 1 të LPP-së, pasi nuk ka arritur:

të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve gjatë procesit të rivlerësimit të ofertave;

të garantojë mosndikimin nga interesat personale, mosdiskriminimin dhe një shkallë të lartë transparence;

të nxisë krijimin e një kulture institucionale profesionale, të paanshme dhe etike, të pandikuar nga interesat materiale.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, edhe pse kanë kaluar më shumë se 10 muaj nga publikimi i Njoftimit për Kontratë, ende nuk ka arritur ta përfundojë me sukses këtë aktivitet të prokurimit. Kjo dëshmon mungesë efikasiteti dhe efektiviteti nga zyrtarët përgjegjës të Autoritetit Kontraktues.

Zyrtarët e Autoritetit Kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, gjatë fazës së rivlerësimit të ofertave, kanë bërë shkelje substanciale të nenit 7 të LPP-së, duke diskriminuar Grupin e OE-ve Olti Trasing SH.P.K. & Fatini SH.P.K. dhe duke na eliminuar nga aktiviteti i prokurimit pa asnjë bazë ligjore, por vetëm duke u mbështetur në pretendimet e OE WOOD CORPORATION L.L.C., të cilin më pas e kanë shpërblyer me kontratë, ndonëse ai nuk i plotëson kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Favorizimi dhe shpërblimi me kontratë i OE WOOD CORPORATION L.L.C., i cili nuk i plotëson kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara, si dhe moskërkimi i sqarimeve gjatë fazës së rivlerësimit të ofertave, dëshmojnë qartë qasjen diskriminuese ndaj Grupit të OE-ve Olti Trasing SH.P.K. & Fatini SH.P.K., të cilët janë eliminuar pa asnjë bazë ligjore.

Asnjë nga artikujt/pajisjet e prodhuesit Oztiryakiler Madeni Esya San. ve Tic. A.S. nga Turqia, me të cilat ka ofertuar OE: WOOD CORPORATION L.L.C., as për së afërmi nuk i plotësojnë specifikat teknike të kërkuara nga AK – Kuvendi i Komunës së Prishtinës në Dosjen e Tenderit, Aneksi 1 – Specifikat Teknike të Detyrueshme.

Tabela e krahasimit të specifikave teknike të kërkuara nga AK dhe specifikave teknike me të cilat ka ofertuar OE: WOOD CORPORATION L.L.C.

Artikulli nr. 58 – Cooker / Sobë

Specifikat teknike të kërkuara në Aneksin nr. 1 të DT:Dimensionet:W-870 (gjatësia)D-800 (gjerësia)H-710 (lartësia)Fuqia: 31.8 kWPesha: 90 kgFurrë me kapacitet 2 x GN 2/1Funksionon me gaz LPG ose gaz natyralë pajisur me valvula sigurie magnetikeSistemi me ndezje përmes pilotitPllaka prej gize të emaluar dhe të fortëStrukturë e jashtme prej çeliku inox ,Lehtë për t'u pastruar dhe higjienike

Specifikat teknike me të cilat ka ofertuar OE: WOOD CORPORATION L.L.C.

Dimensionet:L-800W-870H-850Fuqia: 34 kWFurrë me kapacitet GN 2/1Furrë me kontroll valvulash termostatike të gazitPesha nuk është e specifikuar

Koment:As për së afërmi nuk i plotëson dimensionet e kërkuara nga AK.Ky ndryshim i madh shihet edhe në foton e paraqitur në katalogun e OE fitues.Ju lutem krahasoni foton e katalogut të OE fitues me foton që AK ka publikuar në Aneksin nr. 1 të DT.Nuk e plotëson fuqinë në kW. Është kërkuar fuqi 31.8 kW, ndërsa ka ofertuar me fuqi 34 kW.Është kërkuar pesha 90 kg, ndërsa në katalog nuk është e shënuar pesha.Është kërkuar furrë me kapacitet 2 x GN 2/1, ndërsa ka ofertuar me GN 2/1.Ky ndryshim është substancial.

Kapaciteti i furrës me të cilën ka ofertuar OE fitues është 50% më i vogël se kapaciteti i kërkuar nga AK.

Ndryshimet janë substanciale.Artikulli nr. 59 – Grill / SkarëSpecifikat teknike të kërkuara:Dimensionet:W-870 (gjatësia)D-800 (gjerësia)H-710 (lartësia)Fuqia: 16 kWPesha: 89 kgDy zona të ndara ngrohjeje për gatim të pavarurSipërfaqe gatimi prej gize të emaluar dhe të fortëTrupi i jashtëm prej çeliku inoxLehtë për t'u pastruar dhe higjienikeSistemi i ndezjes piezoelektrike për secilin modulSirtar për mbledhjen e vajit, i lëvizshëm dhe i lehtë për pastrimSpecifikat teknike me të cilat ka ofertuar OE:

Dimensionet:L-700W-700H-280Fuqia: 14 kW

Koment:As për së afërmi nuk i plotëson dimensionet e kërkuara nga AK.

Ju lutem krahasoni foton e katalogut të OE fitues me foton që AK ka publikuar në Aneksin nr. 1 të DT.

Është kërkuar lartësia 710 mm, ndërsa ka ofertuar me 280 mm. Ky është ndryshim substancial, pasi lartësia e skarës së ofertuar është rreth tri herë më e vogël.

Është kërkuar fuqi 16 kW, ndërsa ka ofertuar me 14 kW.

Është kërkuar pesha 89 kg, ndërsa në katalog nuk është e shënuar pesha.

Ndryshimet janë substanciale.

Artikulli nr. 60 – Deep Fat Fryer / Fërgues

Specifikat teknike të kërkuara:

Dimensionet:

W-400 (gjatësia)

D-700 (gjerësia)

H-850 (lartësia)

Kontrollues termostatik

Shportë prej çeliku inox

Valvul për kullimin e vajit në pjesën e përparme

Termostat sigurie për mbrojtje nga mbinxehja

Lehtë për t'u pastruar dhe higjienike

Rezistencat lëvizëse mundësojnë pastrim të lehtë

Trup i jashtëm prej çeliku inox

Kapaciteti: 12 litra

Fuqia: 400V, 9 kW

Pesha: 35 kg

Specifikat teknike me të cilat ka ofertuar OE:

Dimensionet:

L-400

W-700

H-280

Fuqia: 10 kW

Koment:

As për së afërmi nuk i plotëson dimensionet.

Është kërkuar lartësia 850 mm, ndërsa OE fitues ka ofertuar me 280 mm. Ky ndryshim është substancial, pasi lartësia e fërgueses së ofertuar është rreth tri herë më e vogël.

Ky ndryshim shihet edhe në foton e katalogut të OE fitues.

Ju lutem krahasoni foton e katalogut të OE fitues me foton që AK ka publikuar në Aneksin nr. 1 të DT.

Artikulli nr. 61 – Pasta Cooker / Përgatitës i pastave

Specifikat teknike të kërkuara:

Dimensionet:

W-400 (gjatësia)

D-700 (gjerësia)

H-850 (lartësia)

Kontrollues termostatik

Shporta prej çeliku inox

Rubinet për mbushje me ujë

Valvul shkarkimi

Lehtë për t'u pastruar dhe higjienike

Trup i jashtëm prej çeliku inox

Kapaciteti: 12 lt

Fuqia: 400V, 6 kW

Pesha: 34 kg

Specifikat teknike me të cilat ka ofertuar OE: WOOD CORPORATION L.L.C.

Përmasat e pajisjes: 400 x 700 x 270 mm

Dollap i vendosur nën banak: 400 x 635 x 580 mm

Dimensionet:

L-400

W-700

H-280

Fuqia: 5.5 kW

Koment:

As për së afërmi nuk i plotëson dimensionet.

Është kërkuar lartësia 850 mm, ndërsa OE fitues ka ofertuar me 280 mm. Ky ndryshim i dimensioneve është substancial, pasi përgatitësi i pastave me të cilin ka ofertuar OE fitues ka lartësi rreth tri herë më të vogël.

Ky ndryshim substancial shihet edhe në foton që është në katalogun e OE fitues.

Ju lutem krahasoni foton e katalogut të OE fitues me foton që AK ka publikuar në Aneksin nr. 1 të DT.

Është kërkuar fuqi 6 kW, ndërsa ka ofertuar me 5.5 kW.

Është kërkuar pesha 34 kg, ndërsa në katalog nuk është e shënuar pesha.

Ndryshimet janë substanciale.

Artikulli nr. 65 – Pizza Oven / Furrë e picave

Specifikat teknike të kërkuara:

Dimensionet:

W-870 (gjatësia)

D-800 (gjerësia)

H-710 (lartësia)

Fuqia: 12 kW

Pesha: 152 kg

Sistem dere me mbulesë prej çeliku inox

Strukturë e jashtme e lyer me bojë

Sistem dere panoramike

Trup i izoluar, rezistent ndaj temperaturave të larta

Përdorim i lehtë dhe praktik

Sipërfaqe e madhe për gatim

Tregues analog të temperaturës deri në 500°C

Ndriçim i fuqishëm i brendshëm

Ndërfaqe kontrolli miqësore për përdoruesin

Specifikat teknike me të cilat ka ofertuar OE: WOOD CORPORATION L.L.C.

Dimensionet:

W-850

H-760

Fuqia: 10 kW

Pesha: 115 kg

Përmasat e jashtme: 870 x 800 x 710 mm

Përmasat e dhomës së pjekjes: 610 x 610 x 150 mm

Diametri i pjekjes: 300 mm

Kapaciteti: 4 + 4 pizza

Tensioni: 380 V

Koment:

As për së afërmi nuk i plotëson dimensionet.

Asnjë nga dimensionet nuk përputhet me dimensionet e kërkuara nga AK në Aneksin nr. 1 të DT.

Ky ndryshim substancial shihet edhe në foton që është në katalogun e OE fitues.

Ju lutem krahasoni foton e katalogut të OE fitues me foton që AK ka publikuar në Aneksin nr. 1 të DT.

Është kërkuar fuqi 12 kW, ndërsa ka ofertuar me 10 kW.

Është kërkuar pesha 152 kg, ndërsa ka ofertuar me 115 kg.

Ndryshimet janë substanciale.

Artikulli nr. 68 – Steam Oven / Furrë me avull

Specifikat teknike të kërkuara:

Dimensionet:

W-1170 (gjatësia)

D-890 (gjerësia)

H-1040 (lartësia)

Sobë për përgatitjen e ushqimit me avull

Materiali: çelik i pandryshkshëm

Pjesa e brendshme nga alumini

Specifikat teknike me të cilat ka ofertuar OE: WOOD CORPORATION L.L.C.

Dimensionet:

L-1008

W-896

H-1089

Koment:

As për së afërmi nuk i plotëson dimensionet.

Kjo shihet edhe nga fotografia e paraqitur në katalog.

Ju lutem krahasoni foton e katalogut të OE fitues me foton që AK ka publikuar në Aneksin nr. 1 të DT.

Ndryshimet janë substanciale.

Artikulli nr. 80 – Dishwasher / Enëlarëse

Specifikat teknike të kërkuara:

Dimensionet:

W-590 (gjatësia)

D-700 (gjerësia)

H-820 (lartësia)

3 programe të ndryshme: 90 / 120 / 180 sekonda

Pompë standarde për shkarkim uji

Konsum ekonomik i ujit, detergjentit dhe energjisë

Dimensionet e shportës: 500 x 500 mm

Diametri maksimal i pjatës: 320 mm

Rezistencë prej çeliku inox

Sensor sigurie magnetik në kapak

Trup i jashtëm prej çeliku inox

Temperatura e ujit për larje: 55–60°C

Temperatura e ujit për shpëlarje: 80–85°C

Fuqia e motorit: 0.55 kW, 2800 rpm

Fuqia e ngrohjes së rezervuarit të larjes: 2.5 kW

Fuqia e ngrohjes së kazanit të shpëlarjes: 5 kW

Tensioni: 220 V

Pesha: 64 kg

Specifikat teknike me të cilat ka ofertuar OE: WOOD CORPORATION L.L.C.

Dimensionet:

L-595

W-650

H-830

5 programe të ndryshme: 100 / 130 / 150 / 170 / 190 sekonda

Pesha: 70 + 5 kg

Koment:

As për së afërmi nuk i plotëson dimensionet. Kjo shihet edhe nga fotografia e paraqitur në katalog.

Ju lutem krahasoni foton e katalogut të OE fitues me foton që AK ka publikuar në Aneksin nr. 1 të DT.

Është kërkuar me 3 programe, ndërsa ka ofertuar me 5 programe.

Është kërkuar pesha 64 kg, ndërsa ka ofertuar me 70 + 5 kg.

Ndryshimet janë substanciale.

Bazuar në të gjitha këto të dhëna të shënuara më lart në tabelë, shihet se të gjithë artikujt/pajisjet e kompanisë prodhuese Oztiryakiler Madeni Esya San. ve Tic. A.S. nga Turqia, me të cilat ka ofertuar OE: WOOD CORPORATION L.L.C., as për së afërmi nuk i plotësojnë specifikat teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit, Aneksi 1 – Specifikat Teknike të Detyrueshme.

Këto fakte dëshmojnë se komisioni i rivlerësimit të ofertave fare nuk është marrë me vlerësimin e ofertës së OE: WOOD CORPORATION L.L.C. dhe, përkundër faktit se oferta e këtij OE-je as për së afërmi nuk i ka plotësuar kriteret dhe specifikat teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe Aneksin 1 – Specifikat Teknike të Detyrueshme, komisioni i rivlerësimit të ofertave, pa asnjë bazë ligjore, i ka rekomanduar Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit që këtë kompani ta shpërblejë me kontratë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori ekonomik "Olti Trasing SH.P.K." (tutje: "parashtruesi"), më datë 28.04.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës 7 Shtatori – Inventarizimi", me nr. të prokurimit 616-25-6903-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar, si dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (in merito) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

"Konstatimi i AK në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të datës 23.04.2026 se Lista e Kontratave dhe dëshmitë e dërguara nuk e plotësojnë kriterin e kërkuar nga AK nuk qëndron, për faktin se Grupi i OE: Olti Trasing SH.P.K. & Fatini SH.P.K., për ta plotësuar këtë kriter, së bashku me ofertën ka dorëzuar Listën e Kontratave të kompanisë sonë Olti Trasing SH.P.K., ku në listë kemi shënuar vlerën e përgjithshme të realizimit të kontratës me AK – Komuna e Lipjanit, vetëm për mobilie, në vlerë prej 136,000.00 €. Listës ia kemi bashkëngjitur Kontratën me AK – Komuna e Lipjanit, Paramasën me çmime ku janë të shënuara mobiliet dhe Certifikatën – Raportin e Pranimit Teknik të datës 19.12.2022.

Gjithashtu, së bashku me ofertën kemi dërguar edhe Listën e Kontratave të realizuara nga anëtari i Grupit – OE Fatini SH.P.K. nga Shqipëria gjatë periudhës kohore 30.07.2022 deri më 30.07.2025, në vlerë totale të shprehur në euro prej 622,480.00 € (64,302,286 lekë sipas kursit të këmbimit të datës 30.07.2025). Kësaj liste ia kemi bashkëngjitur të gjitha faturat që gjenerohen nga sistemi i Administratës Tatimore të Shqipërisë për çdo shitje të mobilieve për kompani private dhe persona fizikë. Çdo faturë e ka barkodin, ku mund të verifikohet saktësia e të gjitha të dhënave të faturës. Këto fatura sistemi i regjistron automatikisht në Administratën Tatimore të Shqipërisë dhe, bazuar në këto fatura, sistemi automatikisht i kalkulon obligimet tatimore për çdo tatimpagues. Siç e cekëm më lart, çdo faturë e ka barkodin dhe për këtë arsye asnjë faturë nuk nënshkruhet nga blerësi dhe shitësi, por sistemi elektronik i Administratës Tatimore të Shqipërisë e gjeneron automatikisht faturën. Nëse komisioni i vlerësimit të ofertave ka pasur paqartësi, ka pasur mundësi që, konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe nenit 38 të RRPP 002/2022, si dhe nenit 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024, të kërkojë sqarime e jo direkt të na eliminojë nga aktiviteti i prokurimit.

Konstatimi i AK në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të datës 23.04.2026 se z. Endrit Kadriu nuk e plotëson kërkesën e AK-së – Kërkesa 1: Një (1) Master Universitar në Dizajn të Brendshëm, minimum 5 vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme, nuk qëndron, për faktin se së bashku me ofertën kemi dërguar Marrëveshjen, Diplomën, CV-në dhe referencën për përvojën e punës në kompaninë tonë Olti Trasing SH.P.K. Nëse komisioni i vlerësimit të ofertave ka pasur paqartësi, ka pasur mundësi që, konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe nenit 38 të RRPP 002/2022, si dhe nenit 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024, të kërkojë sqarime e jo direkt të na eliminojë nga aktiviteti i prokurimit. Për t'ju dëshmuar se z. Endrit Kadriu ka punuar në kompaninë tonë Olti Trasing SH.P.K. prej datës 01.08.2017 deri më datën 31.08.2023, së bashku me Kërkesën për Rishqyrtim ju kemi dërguar Pasqyrën e Trustit të z. Endrit Kadriu, ku janë të shënuara të dhënat e deklarimit të kontributeve në paga.

Konstatimi i AK në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të datës 23.04.2026 se z. Valon Jetullahu nuk e plotëson kërkesën e AK-së – Kërkesa 2: Një (1) Bachelor i Arkitekturës së Interierit dhe Dizajnit të Mobileve, minimum 3 vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme, nuk qëndron, për faktin se së bashku me ofertën kemi dërguar Marrëveshjen, Diplomën dhe CV-në për përvojën e punës në kompaninë "Frasheri 1954" SH.P.K. Nëse komisioni i vlerësimit të ofertave ka pasur paqartësi, ka pasur mundësi që, konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe nenit 38 të RRPP 002/2022, si dhe nenit 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024, të kërkojë sqarime e jo direkt të na diskriminojë dhe eliminojë nga aktiviteti i prokurimit. Për t'ju dëshmuar se z. Valon Jetullahu e plotëson kërkesën e AK-së, së bashku me Kërkesën për Rishqyrtim ju kemi dërguar Pasqyrën e Trustit të z. Valon Jetullahu, e cila dëshmon se ai ka punuar në kompaninë Musliu Brothers SH.P.K. prej muajit prill 2023 deri në tetor 2023 dhe në kompaninë "Frasheri 1954" SH.P.K. prej muajit nëntor 2023 deri në muajin dhjetor 2025.

Konstatimi i AK në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të datës 23.04.2026 se oferta jonë nuk e ka plotësuar Kërkesën nr. 6 – Operatori Ekonomik, së bashku me ofertën, duhet të dërgojë te Autoriteti Kontraktues katalogun e prodhuesit për artikullin nr. 73 – Raft muri, nuk qëndron, për faktin se ne së bashku me ofertën kemi dërguar katalogun e plotë për të gjithë artikujt që AK ka kërkuar dhe se specifikat teknike të artikullit nr. 73 janë identike me kërkesën e AK-së. Nëse komisioni i vlerësimit të ofertave ka pasur paqartësi lidhur me specifikat e artikullit nr. 73, ka pasur mundësi që, konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe nenit 38 të RRPP 002/2022, si dhe nenit 10 të Udhëzuesit Nr. 002/2024, të kërkojë sqarime e jo direkt të na diskriminojë dhe

eliminohet nga aktiviteti i prokurimit.

Konstatimi i AK në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar të datës 23.04.2026 se pretendimi i OE-së për certifikatat CE nga organi certifikues "Integra" nga Turqia është pjesërisht i bazuar, për ne është i paqartë, për faktin se në letrën standarde të kompanisë sonë është dashur të shënohen të dhënat lidhur me ofertën tonë e jo pretendimet ankimore të OE: WOOD CORPORATION L.L.C."

Parashtruesi po ashtu ka paraqitur pretendime ankimore sipas të cilave oferta e tenderuesit të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme për arsyet e prezantuara në kërkesën për rishqyrtim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 13.05.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0300 ndërsa me datë 01.06.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0300, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet e bazuar, dhe të lënda të kthehet në rishqyrtim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet ankimore eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0300 ka vlerësuar si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Pretendimi nr.1

Pretendimet kryesore ankimore sipas ankesës 300/26 kanë të bëjnë me arsyet eliminimit të OE ankues, ku në rastin konkret pas kërkesës për rishqyrtim nga një OE tjetër, OE ankues është eliminuar.

Sqarojmë se OE ankues përmes ankesës në OSHP ka ofruar sqarime dhe dëshmi shtesë si për përvojën në fushë të ngjashme ashtu edhe për specifikat teknike.

Megjithatë pas anaizimit të kërkesës për rishqyrtim, përveq ripërsërishtes së arsyeve të dhëna në letrën standard për eliminim të OE, nuk kemi gjetur se AK është përgjigjur në pretendimet

ankimore duke dhënë arsyetim konkret apo kundërargument ndaj pretendimeve të OE ankues.

Përveq se AK nuk ka dhënë kundë argumente dhe përgjigje konkrete në pretendimet ankimore kundër eliminimit të OE ankues, AK nuk ka dhënë përgjigje ose kundër argument as ndaj pretendimeve kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, vetëm duke duke u përgjigjur se oferta e e dorëzuar nga ofertuesi i rekomanduar për kontratë është në përputhje të plotë me gjitha kërkesat e DT.

Përgjigja e AK-së në kërkesës për rishqyrtim është si në vijim :

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, mendimi i ekspertit është se AK nuk e ka trjtuar kërkesën për rishqyrtim në pajtim me dispozitat e nenit 108A të rregullorës për prokurimi publik, andaj eksperti shqyrtues rekomandon që të aprovohet ankesa e OE ankues dhe lënda të kthehet në Rishqyrtim, ndërsa me rastin e rishqyrtimit AK të jap përgjigjet/kunderargumente konkrete në pretendimet ankimore në pajtim me dispozitat e nenit 108/A të RRPP-së.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm pjesërisht konstatimeve të ekspertit shqyrtues por jo edhe rekomandimit të ekspertit shqyrtues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 1, Paneli Shqyrtues ka shqyrtuar me kujdes pretendimet e operatorit ekonomik ankues, si dhe gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura nga eksperti shqyrtues në raportin e tij, PSH verën se eksperti shqyrtues ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues, gjatë trajtimit të kërkesës për rishqyrtim, nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 108/A të Rregullores për Prokurimin Publik, duke arsyetuar se vendimi i nxjerrë mbi kërkesën për rishqyrtim nuk përmban trajtim të detajuar të pretendimeve të operatorit ekonomik ankues dhe as kundërpërgjigje konkrete lidhur me çështjet e ngritura ndaj operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Megjithatë, Paneli Shqyrtues vlerëson se ky konstatim, nuk përbën bazë të mjaftueshme ligjore për aprovimin e plote të ankesës dhe kthimin e të gjithë kesaj procedure në rivlerësim.

Sipas konstatimit të Panelit, kthimi I procedurës në rivlerësim nuk kufizohet vetëm në respektimin formal të elementeve procedurale, por ka për qëllim verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve dhe veprimeve të AK-se në raport me dispozitat e ligjore të LPP-se dhe kërkesat e parashtruara në DT. Për këtë arsye, mungesa e një arsyetimi më të zgjeruar apo e përgjigjeve të detajuara për secilin pretendim të paraqitur nuk mund të konsiderohet automatikisht si shkak për anulimin e vendimit të AK-se, për aq kohë sa nga dokumentacioni i ofruar në E-prokurim lidhur me lëndën mund të vërtetohet se veprimet e AK kanë qenë në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-se.

Paneli vlerëson gjithashtu se kthimi i procedurës për rivlerësim vetëm për shkak të mangësive në arsyetimin e vendimit do të ishte në kundërshtim me parimet e efikasitetit, ekonomikitetit dhe zhvillimit të procedurës brenda një afati të arsyeshëm, veçanërisht në situatat kur të gjitha pretendimet dhe provat përkatëse tashmë ndodhen në shkresat e lëndës dhe po ashtu ka pasur mundësi edhe ekspertit shqyrtues që të jap mendimin e tij profesional lidhur me të gjitha pretendimet ankimore, andaj në mungesë të ketyre përgjigjeve PSH ia fal besimin dhe ta lë në fuqi vendimin e AK, për të cilin vendim AK ka formuar një komision të vlerësimit të cilët supozohen të jenë profesionale dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar "Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës". Atëherë në zbatim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta prolongohet ky aktivitet të prokurimit edhe më tutje dhe paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë, si dhe zhvillimi i kësaj procedure. Njëherit është edhe në diskrecion të AK zbatimi i neneve 59 dhe 60 të LPP, ku për AK nuk ka ndonjë argumenti bindës se OE i rekomanduar mund të jetë i papërgjegjshëm atëherë paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendosë po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar, por e pa mjaftueshme që aktivitetin e prokurimit ta kthejë sërish në ri-vlerësim dhe të prolongojë aktivitetin e prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin për kontratë të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi i shkollës 7 shtatori - Inventarizimi" me nr. të prokurimit: "616-25-6903-1-1-1"

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim përveç nenit 1 dhe 6 mes tjerash edhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të

një personi ose ndërmarrje tjetër, si dhe në nenin 104 të LPP.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Olti Trasing SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: